



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

**LIPJANI RENDITET SI TOP KOMUNA MË
TRANSPARENTE NË KOSOVË PËR VITIN 2020**

VLERËSIMI I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE PËR VITIN 2020

Komuna	Pikët	Përqindje
Rahoveci	90	93.75
Drenasi	88	91.67
Lipjani	88	91.67

Kryetari Imri Ahmeti ka thënë se ndihem mirë që edhe KDI konfirmon edhe një herë që Komuna e Lipjanit mbetet komuna me transparencë të lartë në nivel vendi.

“Falenderoj bashkëpunëtorët e mi që zotimin tonë për transparencë e llogaridhënie të plotë po e zbatojmë së bashku në praktikë”, ka thënë ndër të tjera kryetari Ahmeti, duke falenderuar edhe bashkëpunimin e ngusht me qytetarët lipjanas.

Në natën e Kurban Bajramit, Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan ka organizuar aktivitetin "Merr një ëmbëlsirë, gëzo jetimin"

Kryetari Imri Ahmeti bashkë me Kryetarin e KBI- Lipjan, Zaim Baftiun dhe bashkëpuntor kanë shpërndarë dhurata dhe ëmbëlsira për fëmijët prezent në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan për të shënuar festën e Kurban Bajramit.

Mjetet e grumbulluara do të ndihmohen famijet me jetim.





Mbahet gara "Tour de Lipjan"

Nën kujdesin e Kryetarit Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti është mbajtur gara "Tour de Lipjan" me biçikleta.

Kryetari Ahmeti me këtë rast ka thënë se aktivitete të tilla rekreative janë të dobishme për shoqërin dhe Lipjani tashmë ka hapësirën e nevojshme për organizimin e këtyre aktiviteteve.

Vendi i parë i takoi, Albion Imeri, Vendi i dytë Mustaf Sadiku, dhe vendi i tretë Alban Zejnullahu.



Ka filluar ndërtimi i rrugës Gryka e Shpëtimit në Krojmir me gjatësi rreth 1.8 km

Kryetari Imri Ahmeti ka qendruar në fshatin Krojmir për të parë nga afër fillimin e punimeve në ndërtimin e rrugës Gryka e Shpëtimit, rrugë kjo që për banorët e Krojmit ka vlerë të veçantë, përveq turizmit do të lidhë edhe me fshatin Javur të Komunës së Suharekës.

Kryetari Imri Ahmeti ka thënë se ndihet i lumtur që kemi fatin bashkë të nisim punimet kësaj rruge e cila përveq që është nevojshme për banorët po ashtu është e rëndësishme edhe për turizmin e këtij peisazhi natyror me gjelbërimin dhe bukuritë që ka Gryka e Shpëtimit

Nga ana tjetër banorët e Krojmit i janë gëzuar këtij projekti edhe për faktin e kujtesës, ku gjatë luftës pikërisht në këtë rrugë kishin qarkulluar e strehuar me ditë e javë të tëra banorët e fshatit Krojmir, andaj janë shprehur mirënjohës dhe falenderues ndaj komunës dhe Kryetarit Imri Ahmeti për përkushtimin e tij në realizimin e këtij projekti.



Po vazhdon asfaltimi i rrugëve në Gadime



FOTO: Rr. Shkupit GADIME



Po ashtu ka vazhduar asfaltimi i rrugëve edhe në fshatin Topliqan



Janë asfaltuar rrugët edhe në fshatin Akllap



Ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në Banullë



Është përruruar ndriçimi publik në fshatin Bregu i Zi



Në fshatin Blinajë po ashtu është bërë përrurimi i ndiçimit publik



Kryetari Ahmeti pret në takim Donika Gërvalla Schwarz Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporë



Gjatë këtij takimi Kryetari Ahmeti dhe Zëvendëskryeministrja Schwarz diskutuan për aktivitetet që ka Komuna e Lipjanit për diasporën dhe mundësin e investimeve që mund të bëjnë bashkatdhetarët në Kosovë.

Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi ka nënshkruar marrveshjen për financimin e projektit për rregullimin e kanalizimit në lagjen e komunitetit dhe asfaltimin e rrugicave në fshatin Gadime



Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti me bashkëpunëtor ka marrë pjesë në gurthemelin e ndërtimit të fabrikës së ambalazhit nga kompania “Frutex” që filloi së ndërtuari në territorin e Komunës së Lipjanit.



ZGJATET ORARI PUNËS NË SEKTORIN E GJENDJËS CIVILE NË LIPJAN



Me vendim të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti bëhet zgjatja e orarit të punës për sektorin e gjendjes civile i cili funksionin në kuadër të Drejtoratit për Administratë.

Spektori i gjendjes civile nga data 12.07.2021 deri më datën 31.08.2021 do të punojë edhe gjatë të Shtunave prej orës 09:00 deri ora 15:00.

Zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrihen në këtë sektorë që ndërliidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shetet e ndryshme të botës, të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit.

Sqarim: Gjithashtu ju njoftojmë se Komuna e Lipjanit ka në shërbim të qytetarëve edhe platformën elektronike e - Kioskun, në të cilin mund të shërbehen 24/7, me dokumente të gjendjes civile.



Kryetari Ahmeti nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Qatar Charity

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Qatar Charity për projektet e ardhshme që do të jenë në të mirën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Gjatë nënshkrimit të këtij bashkëpunimi, Kryetari Imri Ahmeti ka falënderuar përfaqësuesin organizatës Qatar Charity Khalid Abdulla M H Alyafei, për gatishmërinë që kanë treguar që një kohë për ti ndihmuar qytetarët.

Nga ana tjetër, Khalid Abdulla M H Alyafei, ka falënderuar Kryetarin Imri Ahmeti për bashkëpunim të mirë dhe korrekt që ka treguar deri më tani.

Ndryshe, Komuna e Lipjanit viteve të fundit ka bashkëpunuar ngushtë me organizatën Qatar Charity, bashkëpunim i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Kryetari Ahmeti: Jam shumë i lumtur që Komuna e Lipjanit ka përmbushur kriteret dhe është përzgjedhur nga AQH si komuna e parë model për realizimin e projektit Qendrat e Demonstrimit në shëndetësinë e Lipjanit

Kryetari i Komunës Imri Ahmeti së bashku me drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale Merita Bytyqi dhe drejtorin e QKMF-së Agim Krasniqi kanë takar Nicu Fota me bashkpunëtorë nga projekti Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor AQH i financuar nga Agjencia për zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Temë diskutimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi bashkëpunimi në realizimit të projektit Qendrat e Demonstrimit në Komunën e Lipjanit.

Shefi i projektit të Kujdesit Shëndetësor i Qashëm dhe Cilësor Nicu Fota, ka njoftuar Kryetarin Ahmeti se Komuna e Lipjanit është përzgjedhur e para nga AQH si model për implementimin e këtij projekti pas plotësimit të disa kriterëve caktuar e ndër të cilat ishte edhe bashkëpunimi i mirëfillt motivues si dhe përkushtimi i Komunës së Lipjanit ndaj shëndetësisë dhe investimet e bëra në këtë fushë deri më tani.

Ndërsa Kryetari Imri Ahmeti ka falendëuar përfaqësuesit e AQH për bashkëpunimin e AQH me Komunën e Lipjanit si dhe ka shprehur gadishmërinë e tij institucionale për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm.

Kryetari Ahmeti, po ashtu ka theksuar se për qytetarët e Lipjanit është shumë domethënëse të jetë komuna e parë dhe model e një Qendre Demonstruese për shërbime të integruara të qasshme dhe sa më cilësore të shëndetësisë në Komunën e Lipjanit.



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka pritur në takim Studentin e dalluar Bujar Mehmeti, ku ka ndarë mirënjohje për sukseset e arritura, Studenti Mehmeti është nga fshati Babush i Muhaxherve. Studenti Bujar Mehmeti është duke studiuar në Universitetin Debrecenit - Hungari.


Studenti Mehmeti ka përfaqësuar Kosovën në SHBA - Universitetin e New York-ut, medalja e bronzte, përfaqësues i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar - Universiteti Cambridge Medalja e art, Mehmeti po ashtu është anëtar i bordit drejtues të Astronomy Outreach of Kosova.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti uroj për të gjitha sukseset e arritura, duke dëshiruar shëndet në rrugëtimin e tij në karrierë

Sheshi "Adem Jashari" Lipjan



Parku Nacional Blinaja





BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET